



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

AVOKIMI PËR POLITIKA TË KONKURENCËS

SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË

7



**SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË (Broshura Nr.7)**

AVOKIMI PËR POLITIKA TË KONKURRENCËS

"Avokimi i konkurrencës i referohet atyre aktiviteteve të ndërmarra nga autoriteti i konkurrencës në lidhje me promovimin e një mjedisi konkurrues për aktivitetet ekonomike, me anë të mekanizmave jo-zbatues, kryesisht përmes marrëdhënieve të tij me subjekte të tjera qeveritare dhe duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për përfitimet e konkurrencës" . (Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës, 2002).

Avokimi i Konkurrencës në Kosovë

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar) ¹, me kërkesë të Kuvendit të Kosovës, Qeverisë, organeve publike qendrore ose lokale ose të ndërmarrjeve publike, Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, u kërkohet të japin mendimin e tyre profesional në lidhje me ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera nënligjore që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut². Për më tepër, Autoriteti mund t'u ofrojë këtyre organeve mendimin e tij profesional në lidhje me përputhshmërinë e ligjeve ekzistuese dhe rregulloreve tjera me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Mendime të tilla janë krijuar për të inkurajuar njohuritë në lidhje me konkurrencën e tregut, për të përmirësuar nivelin e ndërgjegjësimit dhe të informimit në lidhje me rolin e ligjit dhe politikës së konkurrencës dhe mbi zhvillimet krahasuese të praktikave në fushën e legjislacionit të konkurrencës dhe politikave të konkurrencës.

Përveç kësaj, së bashku me përgjegjësinë për lëshimin e mendimeve në lidhje me pajtueshmërinë e draft ligjeve dhe rregulloreve të tjera me ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar)³ Ligji i akordon Komisionit Kosovar të Konkurrencës edhe rolin e promovimit aktiv të njohurive të konkurrencës në treg

¹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 03 / L-220) i vitit 2010 i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 04 / L-226) të vitit 2014.

² Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 23.

³ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), neni 28.

dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe të informimit për rolin e politikës së konkurrencës.

Deri më tani, Autoriteti ka nxjerrë një numër mendimesh profesionale për çështje shqetësuese në lidhje me konkurrencën në tregun e Kosovës.

Nevoja për Avokimin e Konkurrencës

Është e pranuar ndërkombëtarisht që autoritetet e konkurrencës duhet të bëjnë më shumë sesa thjesht të zbatojnë ligjin kombëtar të konkurrencës. Kjo sepse konkurrenca mund të zvogëlohet ndjeshëm nga politikat e ndryshme publike dhe rregullimet institucionale si dhe nga sjelljet specifike (të gabuara) të pjesëmarrësve në treg. Në fakt, praktikatat kufizuese të biznesit privat shpesh lehtësohen nga ndërhyrje të ndryshme të qeverisë në treg (p.sh. duke dhënë të drejta monopoli ose përmes marrëveshjeve të licencimit që kufizojnë hyrjen e bizneseve në treg). Kështu që, mandati i një autoriteti të konkurrencës duhet të shkojë përtej thjesht zbatimit të ligjit të konkurrencës dhe të shohë autoritetin gjithashtu të marrë pjesë më gjerësisht në formulimin e politikave ekonomike të vendit të tij, të cilat mund të ndikojë negativisht në strukturën konkurruese të tregut, sjelljen e biznesit dhe performancën ekonomike. Në këtë drejtim, një autoritet modern i konkurrencës duhet të marrë rolin e *avokatisë të konkurrencës*, duke vepruar në mënyrë pro-aktive për të sjellë politika qeveritare që ulin pengesat për hyrjen e biznesit në treg, promovojnë rregullore më të pakta dhe liberalizimin e tregtisë si dhe të cilat përndryshe minimizojnë ndërhyrjen e panevojshme të qeverisë në treg.

Për më tepër, është gjithashtu e pranuar gjerësisht që avokimi i konkurrencës mund të jetë veçanërisht kritik për vendet në zhvillim⁴. Janë disa ngjarje që ndodhin në fazat formuese të një ekonomie tregu, duke përfshirë këtu privatizimin dhe reformën rregullative, të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e

⁴ Për shembull, shikoni: "Sfidat e Avokimit të Konkurrencës për Vendet në Zhvillim", OECD, 2005.

ekonomisë së re, prandaj pjesëmarrja e autoritetit të konkurrencës si avokat i konkurrencës ka një vlerë të dukshme në këtë drejtim. Për më tepër, shumica e vendeve në zhvillim kanë mungesë të një kulture të përshtatshme të konkurrencës dhe është e rëndësishme që autoriteti i konkurrencës të fillojë procesin e ndërtimit të një kulture të tillë. Këto rrethana sugjerojnë që autoritetet e konkurrencës në vendet në zhvillim duhet të jenë relativisht më aktive në avokimin e konkurrencës në krahasim me homologët e tyre në vendet e zhvilluara. Megjithatë, në të njëjtën kohë ata mund të kenë mungesa themelore për ta bërë këtë - ata mund të mos e kenë ende legjislacionin e nevojshëm, burimet ose besueshmërinë e nevojshme për një avokim efektiv. Është e qartë, kjo mund të marrë pak kohë për tu zhvilluar.

Perspektiva përpara

Siç u përmend më herët, Autoriteti ka punuar në ngritjen e vetëdijes dhe informimin e publikut në lidhje me rolin e tij dhe rëndësinë e një konkurrence të qëndrueshme në tregun e Kosovës.

Deri më sot, kjo është përqendruar kryesisht në përmirësimin e marrëdhënieve të Autoritetit me mediat (përfshirë marrëdhëniet e drejtpërdrejta dhe iniciativat e mediave sociale për të prezantuar dhe shpjeguar aktivitetet e tij). Autoriteti është gjithashtu i angazhuar në monitorimin e mediave si një burim informacioni mbi praktikatat specifike të tregut të cilat përfundimisht mund të shkaktojnë shqetësime të konkurrencës.

Për më tepër, AKK -ja i ka lëshuar një mendim Qeverisë për shqetësimet e konkurrencës (në bazë të nenit 23 të Ligjit) lidhur me zgjedhjen e ofruesve të licencuar të shërbimeve për testimin e automjeteve motorike. Gjithashtu, AKK-ja ka themeluar memorandume mirëkuptimi për të promovuar veprime të përbashkëta dhe bashkëpunim me disa organe të tjera publike përfshirë një marrëveshje me Policinë e Kosovës në Mars 2020, e cila përveç të tjerash, u mundëson zyrtarëve të AKK-së që të kërkojnë ndihmën e Policisë në kryerjen e bastisjeve të paparalajmëruara (zakonisht të njohura si “bastisjet në agim”) ndaj subjekteve të dyshuara për shkelje të rregullave të konkurrencës.

Sidoqoftë, Autoriteti sheh hapësirë të konsiderueshme për avokim të mëtejshëm në të gjithë sektorët ekonomikë në Kosovë. Prandaj, janë duke u përgatitur propozimet e reja legjislative për të përforcuar rolin e Autoritetit, veçanërisht në lidhje me ofrimin e mendimeve për konkurrencën për draft legjislacionin dhe për të kërkuar veprime specifike dhe përgjigje ndaj rekomandimeve nga Autoriteti në lidhje me ndonjë shqetësim specifik për konkurrencën. Për më tepër, Autoriteti synon të zgjerojë aktivitetet e tij për të siguruar arritur shpërndarja e mesazheve kryesore në lidhje me vlerën e konkurrencës në treg dhe bashkëpunimin më të ngushtë me shoqatat e biznesit, organet të caktuara publike, mediat dhe grupet e konsumatorëve.

Informacione të mëtejshme

Për informacione të mëtejshme, shihni broshurat e tjera në serinë e AKK-së ***“Sigurimi i përfitimeve nga Konkurrenca e Drejtë”*** dhe vizitoni faqen tonë në internet: <https://ak.rks-gov.net/>



**Funded by
the European Union**



Kjo broshurë është përgatitur me ndihmën e Projektit të financuar nga BE: "Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore" menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe zbatuar nga një Konsorcium i B&S Europe

